



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2020

**Prishtinë, korrik 2021**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

## Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkjmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Agim Aliu , Kryetar i Komunes

Adresa: Rr."Deshmoret e Kombit" , Ferizaj, Republika e Kosovës

## 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

### Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt (Komuna e Ferizajt), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Ferizajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Mos regjistrimi në SIMFK i pesë pagesave për pasuri në shumë prej 2,320,659€ si investime në vijim dhe mos prezantimi i pasurive nën 1,000€ në PFV ka rezultuar me nënvlerësim dhe prezantimin jo të saktë të vlerës së pasurive me të cilat disponon komuna.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Ferizajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Ferizajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## **Baza për konkluzion**

B2 Në 11 raste në shumë 621,122€ vonesat në pagesën e faturave ishin mbi 30 ditë. (në dy raste\* faturat ishin para vitit 2020, kurse në 9 raste faturat ishin të vitit aktual)

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Ferizajt.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Ferizajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Ferizajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë,

por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Ferizajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Ferizajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

**Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike<sup>4</sup>**



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e pasurive

#### Gjetja

Rregullorja MF-nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton qartë rregullat dhe procedurat për menaxhimin e pasurive dhe stokeve. Ne identifikua mangësitë si në vijim:

- Pesë pagesa për pasuri (Ujësjiellës) në shumë 2,320,695€ nuk ishin evidentuar në regjistrin e pasurive kapitale - SIMFK si investime në vijim duke e nënvlerësuar vlerën e pasurisë në PFV;
- Komuna që katër (4) vite nuk ishte duke e aplikuar sistemin e-pasuria për regjistrim të pasurisë jo kapitale nën 1,000€ dhe për pasojë këto pasuri nuk kishin vlerë të shpalosur në PFV. Për më tepër edhe për pasuritë e blera gjatë vitit 2020 nuk ka asnjë lloj evidence as në Excel apo ndonjë softwer tjetër ndërsa sipas evidencave të thesarit shpenzimet (kodet e pasurive nën 1,000€) vetëm për vitin 2020 ishin në shumë 208,890€; dhe
- Raporti i inventarizimit nuk ishte i nënshkruar e as i plotë dhe se nuk ishte kryer para përgatitjes së pasqyrave financiare siç parashihet me rregullore.

Shkaqet e këtyre mangësive janë kryesisht mosfunksionimi i sistemit të e-pasurisë, neglizhenca e zyrtarit të pasurisë dhe vëmendja e pamjaftueshme e menaxhmentit për të vendosur kontrole efektive në menaxhimin e pasurive.

#### Ndikimi

Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e pasurisë, kanë ndikuar në nënvlerësimin e pasurive në PFV. Po ashtu, menaxhimi jo i mirë mund të ketë ndikim në tjetërsimin apo humbjen e pasurive me të cilat është ngarkuar komuna.

#### Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës si dhe shpalosur saktë në PFV. Sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet, për të mundësuar menaxhimin dhe kontrollin më të mirë të pasurive. Po ashtu, komisioni për inventarizim duhet të funksionoj sipas kërkesave për të mundësuar azhurnimin e regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B2 - Vonesa në pagesa të obligimeve

**Gjetja** Rregulla financiare Nr. 01/2013/MF neni 41 përcakton “Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës”. Ne kemi identifikuar se:

Në 11 raste në shumë 621,122€ (në dy raste\* faturat ishin para vitit 2020, kurse në 9 raste faturat ishin të vitit aktual) vonesat në pagesën e faturave ishin deri në 4 muaj.

Vonesat ishin kryesisht të shkaktuara nga mungesa e mjeteve buxhetore dhe planifikimi jo i mirë për kryerjen e obligimeve sipas afateve të përcaktuara.

**Ndikimi** Vonesat në realizimin e pagesave rrisin rrezikun që në periudhat e ardhshme komuna të ballafaqohet me konteste gjyqësore apo veprime përmbarimore të cilat njëherit mund të rezultojnë me obligime shtesë të cilat e rëndojnë buxhetin e komunës.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efikas të kontrolleve financiare për raportimin e saktë të obligimeve dhe kryerjen e pagesave brenda afatit të paraparë ligjorë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



## 2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2020 ishin në vlerë 3,081,495€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte rënie të të hyrave prej 1,480,129€ krahasuar me vitin paraprak për shkak të situatës së pandemisë me Covid 19. Përveç të hyrave direkte, komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte në vlerë prej 638,519€ (dënimet në trafik 592,798€, gjobat e gjykatave 45,280€ dhe të hyrat nga agjencia e pyjeve 441€).

#### Çështja C1 - Mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore

##### Gjetja

Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20%, e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës. Poashtu sipas nenit 31, pika 6 e Ligjit për tatimin në pronë nr.06/L-005, komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar. Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Nga 46,150 prona që dispononte komuna (objekte sipas raportit të punës së datës 25.01.2021), në vitin 2020 kishte arritur të inspektoj 4,652 apo 10% e pronave të paluajtshme; dhe
- Në vitin 2020 komuna kishte pranuar 293 ankesa për tatimin në pronë e ku 257 prej tyre ishin aprovuar në favor të tatimpaguesve. Përderisa vonesat në shqyrtimin e ankesave përtej afateve të lejuara për trajtim ishin prej 3 deri në 6 muaj.

Sipas menaxhmentit verifikimi jo i plotë i pronave dhe trajtimi me vonesë i ankesave kishin ndodhë edhe për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19.

##### Ndikimi

Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë. Vonesat në trajtimin e ankesave ndikojnë në mos azhurnimin e informatave në kohë për vlerësimin e duhur të tatimi në pronë.

##### Rekomandimi C1

Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, personeli i Tatimit në Pronë duhet të shqyrtoj ankesat brenda afatit të përcaktuar.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 15,883,081€, prej tyre ishin shpenzuar 15,865,122€ apo rreth 100%. Numri i lejuar i stafit me buxhet/planifikim ishte 2,411 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,392. Ne kemi testuar 41 mostra prej tyre 33 për teste substanciale, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja A1 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedurat të veçanta ligjore

**Gjetja** Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114 në neni 84 thekson se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Komuna në vitin 2020 kishte angazhuar për shërbime të veçanta 33 punonjës pa zhvilluar ndonjë procedurë. Ne analizuam angazhimet pas hyrjes në fuqi të Ligjit për zyrtarët publik, dhe verifikuam se në të gjitha rastet kontratat ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit. Kryesisht këto pozita ishin pozita të rregullta të punës (jo specifike) si për zyrtar zotues, e-pasurinë, për sektorin e kadastrit etj.

Sipas menaxhmentit kjo ishte pasojë e mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit.

**Ndikimi** Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancën e tyre në punë.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B3 - Lista jo e plotë e pagave****Gjetja**

Rregulla financiare nr. 01-2013/MF neni 33 parasheh që Organizata Buxhetore duhet të siguroj që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave. Po ashtu, edhe neni 12.1 i ligjit nr. 07/L - 001 për ndarjet buxhetore 2020, përcakton se “Asnjë OB nuk mund të tejkalojë numrin e të punësuarve në nivel të nënprogramit, të paraqitur në tabelat 3.1; 3.2 dhe 4.1 të bashkëngjitur në këtë Ligj.

Komuna gjatë vitit 2020 nuk kishte arritur që në listën e pagave të regjistroj edhe 28 të punësuar. Mësimdhënësit e angazhuar jashtë listës së pagave, nuk ishin kompensuar dhe Komunës i kishin mbetur si obligime të pagave të papaguara 66,972€. Po ashtu, në PFV ishte prezantuar vetëm një (1) i punësuar jashtë listës së pagave.

Kjo ka ndodhur për shkak se në arsim është shtuar numri i paraleleve më shumë se sa ishin në planin për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-ta për vitin shkollor 2020/2021, mungesa me arsyeje të mësimdhënësve dhe pushimet e lehonisë.

**Ndikimi**

Mos përfshirja e punëtorëve me kontrata të rregullta në listën e pagave ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara dhe vonesat e pagesave rrisin rrezikun e shpenzimeve shtesë përmes procedurave gjyqësore/përmbartimore. Shpalosja jo e saktë e informatave në PFV paraqet informim jo të drejtë të shfrytëzuesve të pasqyrave.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurohet që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave. Në PFV duhet të shpalosen informatat e sakta në lidhje me numrin e të gjithë punëtorëve, përfshirë edhe ata jashtë listës së pagave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbimet komunale ishte 6,733,456€, prej tyre ishin shpenzuar 6,628,488€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, derivate dhe lëndë tjera për ngrohje, komunal, mirëmbajtje të objekteve dhe shpenzime kontraktuese tjera, etj. Ne testuam 33 mostra prej tyre 29 për teste substanciale dhe 4 për teste të pajtueshmërisë.

#### Çështja C2 - Vonesa në vlerësim të ofertave dhe mangësi në menaxhim të kontratave

##### Gjetja

Sipas nenit 41.2 të rregullave të UOPP-së procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve. dhe nenit 81 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, Autoriteti Kontraktues (AK) duhet si pjesë e përgatitjes së aktivitetit të prokurimit të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore. Ne identifikuam se:

- Hapja e ofertave për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me reagencia për nevojat e QKMF-se” (Kontrata kornize prej 59,252€\*) ishte bërë më datën 06.08.2019 ndërsa komisioni për vlerësimin e ofertave ishte formuar më datë 16.09.2019. Procesi i vlerësimit kishte filluar me vonesë mbi një muaj; dhe
- Në tri raste menaxheri i kontratës nuk kishte përgatitur planin për menaxhimin e kontratave si pjesë e përgatitjes së aktivitetit të prokurimit.

Për shkak se zyrtarët përkatës nuk ishin ne dijeni se duhet të bëhet hartimi i një plani të till dhe neglizhencës nga ana e tyre.

##### Ndikimi

Vonesat në vlerësimin e ofertave përveç tejkalimeve ligjore ndikojnë edhe në shtyrjen e përmbushjes së kontratave duke rrezikuar që mjetet e ndara të mos mund të shpenzohen brenda vitit fiskal. Në anën tjetër mungesa e planit për menaxhimin e kontratave rrit rrezikun e përmbushjes së kontratës në përputhje me termat e specifikuar në kontratë.

##### Rekomandimi C2

Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të fillojë menjëherë pas hapjes së ofertave (brenda afateve ligjore), dhe të obligoj menaxherët e kontratave që planet për menaxhimin e kontratave të jenë hartuar para fillimit të zbatimit të tyre në mënyrë që kontratat të monitorohen në baza të rregullta.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 14,341,580€, prej tyre ishin shpenzuar 12,073,655€ apo rreth 84% të buxhetit final. Shpenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve lokale, kanalizime, shpronësime, objekte arsimore e shëndetësore. Testuam 62 mostra për teste substanciale në shumë 5,361,281€, si dhe 4 mostra për teste të pajtueshmërisë.

#### **Çështja C3 - Procedura jo në pajtueshmëri me LPP-në dhe pagesa nga buxheti i projekteve tjera**

##### **Gjetja**

Rregullat e UOPP-së në pikën 56.15 theksojnë që kurdo që AK nuk din sasi të indikativë, atëherë Autoriteti Kontraktues (AK) duhet të përdorë kontratën me çmime për njësi duke e përcaktuar peshën në bazë të rëndësisë së artikujve-shërbimeve, me qëllimin që të marrë ofertën me çmimin më të lirë; dhe

Ligji nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore neni 12 pika 8 thekson se nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizatat buxhetore vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

Në kontratën kornizë "Rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik" identifikuam si në vijim:

- Në dosjen e tenderit nuk ishte definuar nëse ishte duke u aplikuar kontrata kornizë me sasi indikative apo kontrata për çmimin për njësi. Nga analiza e paramasës dhe parallogarisë shihet se në shumicën e pozicioneve AK kishte përcaktuar sasinë vetëm me (1) një, përderisa për disa pozicione kishte përcaktuar sasinë më shumë se (1) një.

- Me datën 29.09.2020 komuna kishte nënshkruar kontratë kornizë tri vjeçare me vlerë të parashikuar 2,380,000€ përderisa vlera e kontratës sipas pozicioneve ishte 86,425€. Në qoftë se kjo kontratë kornizë do të ishte me sasi indikativë atëherë vlera e saj përfshirë edhe 30% që lejohet do të ishte rreth 15% e vlerës së parashikuar të kontratës (86,425\*30%\*3 vite).
- Në pagesën në vlerë prej 110,000€ për këtë projekt vërehet tejkalimi në pozicione mbi 30% (Për elaborim po i theksojmë dy raste psh. pozicioni nr.43 për rrugën Vezir Jashari sasi sipas kontratës ishin 1 kurse të realizuara janë 120 njësi, pozicioni nr.45 sasi sipas kontratës ishin 1 kurse të realizuara janë 9 etj.);

- Përkundër nënshkrimit të kësaj kontrate me vlerën e parashikuar prej 2,380,000€, në buxhetin e vitit 2020 si dhe në vlerësimin për dy vitet e ardhshme, ishin ndarë mjete në vlerë prej 580,000€. Përderisa me buxhetin e vitit 2021 dhe vlerësimin për dy vitet e ardhshme ishte planifikuar vlera e plotë e kësaj kontrate; dhe.

- Një faturë nga kjo kontratë në vlerë prej 20,025€ ishte regjistruar gabimisht në SIMFK si shpenzim për projektin "Kolektori Verior i Kanalizimit Fekal për Fshatin Talinoc.

Bazuar në këto indikacione komuna kishte lidhur një kontratë për çmime për njësi por as në dosjen e tenderit e as vlerësimin e ofertave nuk ishte aplikuar peshimi i cili kërkohet për këtë lloj të kontratës.

#### **Ndikimi**

Mospërfillja e procedurave adekuate gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit rrit rrezikun që të mos përzgjidhet oferta më e mirë për komunën, dhe ndikon që të shfaqen probleme edhe te realizimi i kontratës (duke tejkaluar sasi të prej 30%). Nënshkrimi i kontratave në mungesë të fondeve të mjaftueshme, shkakton vështirësi financiare dhe vonesa në realizimin e kontratave, si dhe rritje të obligimeve të papaguara.

#### **Rekomandimi C3**

Kryetari, duhet të vendos kontrollë shtesë gjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen në pajtim me kërkesat ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për parën e shpenzuar. Për më tepër, kriteret mbi peshimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese në përzgjedhjen e operatorit ekonomik (OE). Po ashtu, para nënshkrimit të kontratave fondet duhet të jenë në dispozicion, dhe regjistrimi i shpenzimeve të jetë nga projekti adekuat.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Dobësi në realizimin dhe menaxhimin e kontratave**

##### **Gjetja**

Sipas nenit 61.23 të rregullave të UOPP-së “Ndryshimi i kontratës nuk do t’i lëshohet OE para marrjes së aprovimit nga ZKA”. Sipas nenit 61.19 Përgjegjësi e menaxherit të projektit është të menaxhojë obligimet dhe detyrat e AK-së të specifikuar në kontratë dhe të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Ne identifikuam mangësi në menaxhimin e kontratave si në vijim:

- Për kontratën “Asfaltimi i rrugës në fshatin Bibaj” në vlerë 318,071€, kishte ndryshim të sasive nëpër pozicione. Nga 164 pozicionet e paramasës dhe paralogarisë në 88 (apo 50%) prej tyre kishte ndryshim të sasive (rritje apo zvogëlim). Ndryshimi i sasive sillej nga 10 – 60% nëpër pozicione të ndryshme edhe pse çmimi total i kontratës nuk kishte ndryshuar. Aprovimet për këto ndryshime nuk ishin marr nga ZKA, por vetëm nga menaxheri i projektit. Kjo kishte ndodhur për shkak se me rastin e planifikimit të projektit nuk ishin marrë parasysh nevojat reale për këtë projekt;
- Për kontratën “Asfaltimi i rrugicave në qytetin e Ferizajt LOT II” në vlerë 458,714€ ishte paraparë që të asfaltohet edhe rruga “Selman Riza” në vlerë prej 47,874€. Bazuar në raportin e pranimit teknik kjo rrugë nuk ishte ndërtuar për shkak të problemeve pronësore, por që këto mjete ishin shpenzuar për ndërtimin e rrugëve dhe kanalizimeve tjera të cilat nuk ishin paraparë në kontratën bazë; dhe
- Për kontratën “Ndërtimi i shkollës së mesme në komunën e Ferizajt” në vlerë 1,803,726€ kishte vonesa në përfundimin e punimeve, pasi që ishte bërë ndërrimi i vendit të lokacionit për ndërtimin e shkollës

dhe sigurimi i vendimit për leje ndërtimore kishte shkaktuar vonesë për fillimin e punimeve. Punimet duhej të përfundonin me 20.11.2020 sipas kontratës, mirëpo deri në shkurt të vitit 2021 punimet nuk ishin përfunduar.

Mungesa e llogaridhenies nga menaxheri i projektit ishte shkak që punimet nuk ishin ekzekutuar në pajtueshmeri me sasisë e caktuara në paramasë dhe parallogarin e kontratës.

**Ndikimi**

Mungesa e aprovimeve paraprake për ndryshime, dhe mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuara në kontratë tregon se planifikimi dhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara duke ndikuar që punët të vonohen dhe mos realizohen siç ishin me kontratë. Problemet e tilla mund të sjellin edhe vështërsi financiare.

**Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e hartimit të paramasës dhe parallogarisë janë vlerësuar saktë pozicionet që duhet punuar, në mënyrë që ndryshimet gjatë ekzekutimit të projektit të minimizohen. Po ashtu, menaxherët e kontratave duhet të raportojnë çdo largim/shtim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga ZKA. Po ashtu, duhet eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



**Çështja A3 - Ndarja jo e drejtë e detyrave****Gjetja**

Neni 62.3 pika 1 e rregullave të UOPP-së thekson se zyrtari përgjegjës i prokurimit do të nënshkruajë një kontratë, por është i ndaluar që të nënshkruajë pranimin e mallrave, punëve, ose pagesën e një fature, kurse pika 7 thekson se një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i projektit. Ne identifikuam dy raste në të cilat nuk ishte bërë ndarje e duhur e detyrave:

- Në kontratën “Asfaltimi i rrugës në fshatin Bibaj” (vlera 318,071€) menaxheri i prokurimit kishte nënshkruar kontratën dhe raportin e komisionit për pranim teknik në cilësinë e kryesuesit të komisionit për pranim teknik; dhe
- Në tenderin për “Ndërtimi dhe vendosja e kontinjerave mbitokësor, furnizimi me kontinjer dhe komposter” një anëtarë i komisionit të vlerësimit ishte caktuar menaxher i kontratës dhe kishte nënshkruar raportin e pranimin.

Ndarja jo e drejtë e detyrave ishte rezultat i kujdesit të pamjaftueshëm të menaxhmentit në parandalimin e konfliktit të detyrave.

**Ndikimi**

Kontrollet jo efektive kanë mundësuar përfshirjen e zyrtarëve të njëjtë në dy faza të procesit e që kjo është në kundërshtim me parimet e ndarjes së detyrave si konflikt interesi dhe mund të ndikojë në procesin e vlerësimit dhe në cilësinë e menaxhimit të kontratave.

**Rekomandimi A3**

Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Menaxheri i prokurimit nuk duhet të përfshihet në pranimin e punëve e as zyrtarët të cilët janë të përfshirë në vlerësimin e tenderëve nuk mund të angazhohen në menaxhim të kontratave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## **Çështja A4 - Siguria e ekzekutimit jo e plotë**

### **Gjetja**

Sipas nenit 30 për rregullat dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës, si parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës. dhe do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Ne kemi identifikuar katër (4) raste\* ku siguria e ekzekutimit nuk mbulonte tërë periudhën e kërkuar të kontratave. Siguria e ekzekutimit ishte për një ose dy vite por në asnjërin nga rastet nuk ishte për periudhën e kërkuar 2 apo 3 vjeçare.

Mos funksionimi i sistemit të kontrollit në departamentin e prokurimit i'u ka mundësuar operatorëve ekonomik që para nënshkrimit të kontratave ta sjellin sigurinë e ekzekutimit për periudhe jo të plotë të kontratave.

### **Ndikimi**

Siguria e ekzekutimit që nuk mbulon tërë periudhën e kompletimit të kontratave (30 ditë pas kompletimit të kontratave) rrit rrezikun e mos përmbushjes së kontratave në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara, dhe pamundëson AK që të ketë një mekanizëm të rëndësishëm financiar për monitorimin dhe zbatimin e kontratës.

### **Rekomandimi A4**

Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që siguria e ekzekutimit është në përputhje me afatet e paraparë për përmbushjen e kontratave, në të kundërtën nuk duhet të lidhet kontrata. Pra siguria e ekzekutimit duhet të jetë valide për një periudhë prej tridhjetë ditë pas kompletimit të kontratave.

## **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.5 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë paraqitur çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale.

#### Çështja B4 - Shpenzimet e larta për procedurat përmbartimore

**Gjetja** Neni 39 i LMFPP përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Pagesat e realizuara nga thesari bazuar në vendime gjyqësore /përmbartimore gjatë vitit 2020 ishin 1,390,600€\*. Prej tyre sipas raportit të pranuar nga ZKF borxhi kryesor ishte 1,278,054€ kurse shpenzimet procedurale të gjykatës (përmbartimit) ishin 112,546€. Ne kemi testuar 6 mostra në shumë prej 400,558€ dhe verifikuam se këto mostra ishin të prezantuara saktë në raportin që na është ofruar nga ZKF.

Pagesat kishin të bënin me vonesat në pagesën e faturave ndaj operatorëve ekonomik si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore.

**Ndikimi** Mos pagesa me kohë e obligimeve ka ndikuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga Thesari. Kjo situatë rezulton direkt në rritjen e kostos për Komunën dhe pamundëson realizimin e projekteve të aprovuar për vitin përkatës.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja C4 - Tejkalmi i vlerës së kontratave

**Gjetja** Sipas nenit 56.10 të rregullave të UOPP-së mospërputhja e lejuar tek kontratat kornizë nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, Ne identifikuar dy\* raste ku pagesat për pozicione ishin përtej limiteve të lejuara prej 30% si në vijim:

- Në tri pagesa të testuara për kontratën kornizë "Mirëmbajtja e rrugëve-shenjat e komunikacionit Lot V - Pajisje tjera ndërtimore", kemi vërejtur se në 11 pozicione kishte tejkalime të sasive mbi 30% apo në vlerë 107,654€; dhe
- Në dy pozicione situacioni-V-demolimi me kujdes i kubëzave të vjetra dhe palosjen e tyre në vendpunishte për ripërdorimin e mëvonshëm dhe pastrimi tek kontrata "Riparim i trotuareve me kubëza në rrugën Enver Topalli" ishin tejkaluar 792€ mbi limitin+30%.

Tejkalimet kishin ardhur si pasojë e planifikimit të dobët të sasive indikative dhe mos parandalimi i tejkalimeve nga menaxherët e kontratave.

**Ndikimi** Tejkalimi i limiteve të lejuara në kontratat kornizë ndikon në komplikime/vështirësi financiare te komuna si dhe rrit rrezikun në mos realizimin e të gjitha projekteve të planifikuara.

**Rekomandimi C4** Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për një planifikim të drejtë të sasive indikative të kontratave kornizë në mënyrë që shpenzimi i buxhetit të bëhet në pajtim me tolerancën e lejuar +/- 30%. Tejkalimet e kontratave në këtë formë duhet të ndërprehen nga menaxherët e kontratave si preventiv për përmirësimet në të ardhmen.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 11,899,631€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 9,894,262€, taksa e bizneseve 769,687€, qiraja 123,421€, leje ndërtimore 1,109,065€ dhe çerdhja 3,196€.

#### Çështja B5 - Rritja e Llogarive të Arkëtueshme

##### Gjetja

Rregullorja 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizata buxhetore, neni 16 përcakton se të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme, pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite, në raport me vitin paraprak ato janë rritur për 2,135,632€. Komuna nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për mbledhjen/realizimin e llogarive të arkëtueshme.

Rritja më e madhe ishte te tatimi në pronë i cili ishte i ndikuar edhe nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të menaxhuara/privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Këto borxhe (të akumuluar ndërvite) janë përafërsisht 1,587,275€. Problemet në inkasimin/rritjen e këtyre borxheve paraqiten pasi që pronat e AKP-së sipas evidencës në total ishin 144, përderisa 104 prej tyre nuk ishin aktive por që borxhi është evident.

Përkundër se edhe vitet paraprake nuk ishte gjendja e mirë e menaxhimit të LLA, në këtë vit ka ndikuar gjendja e krijuar me Covid-19.

##### Ndikimi

Rritja e LLA nëpër vite, dhe mos marrja e veprimeve për inkasim të tyre, ndikon në përkeqësimin e performancës së inkasimit të këtyre llogarive dhe nga ana tjetër ndikohet trendi negativ i rritjes vit pas viti duke rrezikuar arkëtimin e tyre.

##### Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj procedura të qarta për inkasimin e LLA, gjithashtu duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë në menaxhimin e tyre dhe që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B6 - Shpalosje jo e saktë e Llogarive të Arkëtueshme (LLA) në PFV****Gjetja**

Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar neni 16 i obligon organizatat buxhetore që mbledhin të hyra që të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave”. Bazuar në informatat e pranuar dhe testimeve tona kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Komuna në PFV kishte nën vlerësuar LLA për 82,266€, prej tyre 43,657€\* ishin për leje të ndërtimit (fatura të papaguara të vitit 2015 dhe vitit 2016) si dhe 38,609€ për qiratë të cilat ishin joaktive dhe kishin obligime ndaj komunës.

Kjo ka ndodh pasi që komuna nuk ka një databazë ku mbahen shënime e LLA, poashtu nuk ka një komunikim formal në mes drejtorisë së financave, ZKF dhe drejtorive që mbledhin të hyra. Nën vlerësimi tek leje ndërtimi ka ndodh pasi që drejtorja e urbanizimit nuk mban shënime të sakta për kështet e papaguara për leje ndërtimi. Ndërsa për qiratë, ato ishin nën vlerësuar pasi që borxhet më të vjetra nuk ishin paraqitur fare në PFV.

**Ndikimi**

Mungesa e shënimeve të sakta dhe të strukturuar në lidhje me LLA, ndikojnë në pasqyrimin jo të vërtetë të gjendjes reale të këtyre llogarive dhe në shpalosjen jo të saktë të tyre në PFV. Kjo po ashtu mund të ndikoj në humbjen e të dhënave dhe humbjen e të drejtës së arkëtimit të tyre.

**Rekomandimi B6**

Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të siguroj nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Të përgatit një plan veprimi për arkëtimin e tyre duke ndjekur procedura ligjore, me këshillim nga zyra e avokatit të komunës për veprimet ligjore. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen nëpër vite me një kujdes të veçantë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B7 - Mungesa e mekanizmave për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme****Gjetja**

Gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme kemi hasur në dobësi të shumta, tek LL/A për borxhet e vjetra për të cilat komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore. Dobësitë janë paraqitur në vijim:

- Në anex kontratën e dt.02.09.2008 në mes Komunës dhe Shoqatave të dala nga lufta dhe shoqatës së të burgosurve politik për shfrytëzimin e pronës komunale - vend parkimi në rrugët “Dëshmorët e Kombit” dhe “Ahmet Kaçiku”, në pikën II parashihet qiraja mujore prej 3,000€.

Vlera e borxheve ndaj komunës për këto vend parkime kishte arritur në 208,560€. Kuvendi Komunal me vendimin 01.nr.11 të dt.03.02.2017 kishte falur këtë borxh\*. Mirëpo, ky vendim ishte vlerësuar nga komisioni për mbikëqyrjen e ligjshmërisë nga Ministria e Financave me mangësi të bazës ligjore dhe kishte rekomanduar

që për zbatimin e vendimit duhet të ceket baza ligjore dhe të silltet përsëri në shqyrtim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Për më tutje, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me dt.22.02.2017 kishte kërkuar nga Komuna që zyrtarisht të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti/vendimi. Kuvendi komunal nuk e ka rishqyrtuar kërkesën nga MAPL, përderisa MAPL nuk kishte inicuar rastin në gjykatën e qarkut siç kërkohet me nenin 82.4 të Ligjit 03/L-040.

Sipas ZKF përderisa MAPL nuk ka inicuar rast në gjykatë atëherë kjo vlerë nuk është paraqitur si LL/A në PFV, pasi që konsiderohet se vendimi i kuvendit komunal mbetet në fuqi.

- Vendimi i datës 13.04.2017, për shkëputje të kontratës për pronën që gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, pika II. parasheh që të kryhet pagesa e borxhit ndaj komunës vullnetarisht deri në muajin prill në shumë 15,331€, në të kundërtën avokati publik i komunës do të ngris padi për kompensim ndaj pronarit të qiramarrësit.

Komuna nuk kishte marr veprime konkrete për inkasimin e borxhit. Kjo pronë i është dhënë në shfrytëzim me ankand publik të datës 27.08.2018 një qiramarrësi tjetër;

- Kontrata e përkohshme e datës 03.04.2014 “Për shfrytëzimin e pronës komunale në fshatin Muhovc - Tregu i Kafshëve” me një afat deri në procedurat e dhënies së ankandit publik sipas neni 6 parasheh që qiramarrësi është i obliguar të kujdeset për ruajtjen e pronës komunale të marr me qira dhe nuk ka të drejtë të bëjë ndërtime pa lejen e organit kompetent.  
Qiramarrësi pas njoftimit të datës 26.05.2017, për shkëputjen e kontratës në një afat prej një muaji, që prona do të kalojë në posedim të ndërmarrjes Ambienti, kishte ushtruar kërkesë në komunë me datë 21.06.2017 për kompenzimin e aseteve si investim vetanak ose vazhdim kontrate. Me datë 16.11.2017 nga drejtoria e zhvillimit komunal është përpiluar një raport, nga komisioni prej 3 anëtarëve, me një vlerësim të investimit prej 15,340€. Kjo ka obliguar sektorin e të hyrave të bëjë zbritjen në qira për këtë vlerë, duke e lënë në parapagim qiramarrësin për 10,490€. Ky njoftim bie në kundërshtim me kushtet e kontratës, pasi që nuk janë paraparë investime nga qiramarrësi;
- Komuna kishte dërguar vërejtje me datën 25.11.2019 për biznesin “Telekomi i Kosovës”, duke potencuar se “është vërejtja e fundit, dhe duhet të përmbillet në afat prej 5 ditë nga dita e pranimi të vërejtjes, në të kundërtën menjëherë pas kësaj date komisioni për prona publike do të filloj procedurat për anulimin e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe lirimim e pronës.  
Përkundër vërejtjes, ky biznes akoma vazhdon, vetëm se ka një lëvizje pasi që në vitin 2020 kishte realizuar pagesa në vlerë 540€, mbetet sfidë mbledhja e këtyre borxheve pasi që ka borxh vlerën 3,305€; dhe
- Në vërejtjen e datës 10.07.2019 për biznesin SHPK LLC Controll që gjendet në rrugën “D.Islami“-Ferizaj, parasheh se “është vërejtja e fundit dhe se në emër të shfrytëzuesit të pronës komunale me qira, duhet të përmbillet në afat prej 5 ditë nga dita e pranimi të vërejtjes, në të kundërtën menjëherë pas kësaj date komisioni për prona publike do të filloj procedurat për anulimin e kontratës në

mënyrë të njëanshme dhe lirimin e pronës, gjithnjë duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 3.4 ku parashihet shkëputja e kontratës”. Me datë 17.10.2019 komuna ka bërë njoftim për lirimin e hapësirës publike në afat deri me 30.11.2019. Përkundër shkresave kjo ishte faturuar deri në dhjetor 2019, duke arrit shumën e borxhit në 24,596€, duke pohuar se për vitin 2020 nuk është faturuar pasi që pronari është tërjeh nga prona, por nuk na është ofru një dëshmi e tillë.

Në vitin 2020 Komuna nuk kishte ndërmarr hapa për shkak të situatës së krijuar me Covid-19.

**Ndikimi** Kontrollet e dobëta të identifikuar në menaxhimin e LLA dhe mos veprimi për inkasim të LLA të vjetra e sjellin komunën në vështirësi financiare. Po ashtu, mospërfillja e kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e vendimit pa bazë të qarët ligjore, mund të dëmtoj buxhetin e komunës.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të siguroj mekanizma për të vërtetuar historinë e borxheve, për të konfirmuar se nuk janë bërë përshtatje të parregullta apo lëshime. Po ashtu të rishikoj vendimin/raportin për faljen/kompenzimin e borxhit. Borxhet nga pronat publike në pronësi të komunës duhet të përcillen me përpikëri, njëherit për inkasimin e të arkëtueshmeve duhet aplikuar të gjitha veprimet ligjore.

## **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### **Çështja A5 - Llogaritja e të arkëtueshmeve përkundër vendimit për lirim**

**Gjetja** Vendimi i Kuvendit Komunal 01 nr.148 i dt.18.12.2020, pika i potencon lirim-faljen e qirave për lokalet në pronësi të Komunës, për shkak të pandemisë Covid 19.

Sipas këtij vendimi, 18 qiramarrës të pronave komunale ishin përfitues nga lirim-falja. Ne testuam katër mostra dhe vërejtëm se bizneset e liruara nga qiratë për vitin 2020 përkundër lirimit ishin faturuar për 12 muaj. Në aspektin e të arkëtueshmeve ata figurojnë si borxhli edhe pse nuk janë të obliguar të paguajnë qiratë për periudhën e vitit për të cilin vlen vendimi. Vendimi nuk e kishte specifikuar saktë për cilët muaj të vitit vlente lirim-falja nga qiraja.

Bazuar në pohimet e zyrtarëve kjo ka ndodh pasi që vendimi nuk është dorëzuar tek zyrtarja e cila shtyp faturat për qiratë, ku janë faturuar gjatë gjithë vitit qiramarrësit. Po ashtu vendimi nuk është qartë i specifikuar se për cilët muaj të lirohen nga pagesa.

**Ndikimi** Faturimi i bizneseve të liruara nga pagesa e qirasë ndikon në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe njëkohësisht në periudhat e ardhshme krijon konfuzion për borgjet reale të bizneseve.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të financave se vendimet e Kuvendit Komunal zbatohen në procesin e faturimit të qirave. Po ashtu, të rishikoj faturimet e procesuara dhe aty ku ka bazë ligjore të bëhen korrigjimet e nevojshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



### 2.3.7 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 4,018,246€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

#### Çështja B8 - Mangësi në shpalosjen e obligimeve

**Gjetja** Rregullorja MF nr.01/2017 për raportim financiar nga organizatat, neni 17, pika 3, parasheh se organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri me 31 dhjetor të vitit raportues. Ne kemi identifikuar se:

- Në një rast obligimi për shpronësim ishte paraqitur në vlerë 99,671€ kurse vlera e shpronësimit sipas vendimeve ishte 198,071€\*, pra kemi nënvlersim të obligimeve për 98,400€; dhe
- Në nenin 17 të PFV-ve është bërë një gabim (permutacion i shenjave) i obligimeve mbi dhe nën 30 ditë pasi vlerat janë vendosur në vendin e gabuar.

Shkaku i gabimeve/mos raportimeve të plota në PFV ka ardh si pasojë e pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës si dhe duke bërë permutacion të shenjave nën/mbi 30 ditë.

**Ndikimi** Raportimi i mangët i obligimeve dëmton saktësinë e pasqyrave financiare dhe pamundëson planifikimin afatshkurtër të obligimeve.

**Rekomandimi B8** Kryetari duhet të siguroj se obligimet e mbetura në fund vit të raportohen saktë në PFV dhe të gjitha informatat për faturat e papaguara dorëzohen me kohë te ZKF.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.8 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit-drejtori i NJAB-së dhe dy auditor. NjAB për vitin 2020 kishte planifikuar gjashtë auditime të cilat deri në fund të vitit i kishte finalizuar për fushat: mallra shërbime, subvencione, investime kapitale, menaxhimi i resurseve, menaxhim i inventarit, zyra e prokurimit dhe të hyra. Nga këto auditime kanë rezultuar 26 rekomandime prej tyre 4 ishin zbatuar, 13 në proces të zbatimit dhe 9 të pazbatuara. Komuna kishte të themeluar komitetin e Auditimit të brendshëm.

#### Çështja B9 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

##### Gjetja

Neni 8 i UA MF- NR. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik parasheh që KA duhet të mbajë së paku katër mbledhje brenda vitit kalendarik për të shqyrtuar rekomandimet nga raportet e Auditimit të Brendshëm dhe Auditimit të Jashtëm.

Për vitin 2020 KA nuk kishte mbajtur asnjë takim/mbledhje duke pamundësuar ndihmën për ZKA në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes së NjAB-së.

Me datë 05.10.2020 janë ndërruar dy anëtarë komiteti, megjithatë për vitin 2020 KAB nuk kishte mbajtur asnjë takim/mbledhje duke pamundësuar shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes NjAB-së

##### Ndikimi

Mos mbajtja e mbledhjeve nga komiteti i auditimit ndikon negativisht në efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës, funksionimin e auditimit dhe pavarësinë e auditimit të brendshëm.

##### Rekomandimi B9

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e KA-së në mënyrë që Komiteti të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, KA duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>10</sup>	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>36,023,633.63</b>	<b>37,812,509.32</b>	<b>35,334,404.37</b>	<b>31,895,782.48</b>	<b>29,502,712.63</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	28,448,106.63	28,864,901.74	28,652,305.43	25,275,915.67	24,530,366.43
Financimi përmes huamarrjes	0.00	195,580.00	174,702.70	26,496.23	4,362.00
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	2,560,000.00	2,560,000.00	2,320,659.82	1,025,000.00	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	1,050,451.58	1,027,346.99	801,889.66	530,390.57
Të hyrat vetanake	5,015,527.00	5,015,526.12	3,081,850.85	4,698,755.16	4,416,274.09
Donacionet vendore	0.00	101,910.60	57,891.04	51,976.74	19,872.36
Donacionet e jashtme	0.00	24,139.28	19,647.54	15,749.02	1,447.18

Rritja e buxhetit final në raport me buxhetin fillestar ishte në shumë 1,788,876€ kjo rritje ishte nga të hyrat e bartura në shumë 1,050,451€, të hyrave vetanake 1,470,166€, grantet e donatorëve të brendshëm në shumë 101,911€, donacionet e jashtme 24,139€, huamarrja në shumë 195,580€, dhe një reduktim i grandit qeveritar në vlerë prej 1,053,371€.

Në vitin 2020 komuna e Ferizajt ka shpenzuar 93% të buxhetit përfundimtar ose 35,334,404€ me një përmirësim të 6% në krahasim me vitin 2019. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>36,023,633.63</b>	<b>37,812,509.32</b>	<b>35,334,404.37</b>	<b>31,895,782.48</b>	<b>29,502,712.63</b>
Pagat dhe mëditjet	15,625,776.00	15,883,081.11	15,865,122.07	15,310,882.32	15,081,907.86
Mallrat dhe shërbimet	4,589,994.00	6,073,143.05	6,003,802.10	4,291,781.59	3,536,223.74
Komunalitë	659,680.00	660,312.85	624,686.17	622,182.12	533,195.22
Subvencionet dhe transferet	624,392.00	854,392.00	767,139.15	562,282.73	609,628.36
Investimet Kapitale	12,294,298.63	14,341,580.31	12,073,654.88	11,108,653.72	9,741,757.45
Rezervat	2,229,493.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 257,305€, i cili ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,483,149€ fillimisht kishte reduktim të buxhetit sipas vendimit të qeveris në shumë 96,666€, pastaj rritje nga të hyrat e bartura në shumë 593,201€, donacionet dhe huamarrja në shumë 35,564€, rimëkëmbja ekonomike dhe menaxhimi i emergjencave 385,602€ dhe rezerva 565,447€;
- Buxheti final për subvencione kishte rritje për 230,000€, kjo rritje ishte nga rezerva 50,000€ dhe 180,000€ nga të hyrat e bartura; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 2,047,281€, përkundër kësaj rritje të buxhetit realizimi ishte në nivelin prej 84%.


Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 928,511€, prej tyre 520,380€ ishin shtesa në paga, 408,131€ mallra dhe shërbime.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Shpenzimet kishin një trend të vazhdueshëm të rritjes nga viti 2018, ndërsa rritja më të lartë ishte në vitin 2020 krahasuar me dy vitet paraparke.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpenzimet me larta ishin në kategorin e pagave dhe meditjeve dhe investimeve kapitale krahasuar me kategorit tjera.

Të hyrat e planifikuar ishin realizuar në nivelin prej 61%, dhe krahasuar me vitet paraprake kemi një rënie të ndieshme në mbledhjen e tyre dhe për këtë kishte ndikuar pandemia Covid-19.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>5,015,526.00</b>	<b>5,015,526.00</b>	<b>3,081,495.75</b>	<b>4,561,623.88</b>	<b>4,244,208.98</b>
Të hyrat tatimore	2,651,938.00	2,651,938.00	1,369,174.28	1,789,999.24	1,735,617.15
Të hyrat jo tatimore	2,363,588.00	2,363,588.00	1,712,321.47	2,771,624.64	2,505,131.83
Të hyrat tjera	0.00	0.00			3,460.00

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të komunës së Ferizajt ka rezultuar me 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, katër ishin në proces, nëntë të pazbatuara dhe një i mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit, dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në përputhje të plotë me kodet e përcaktuara ekonomike. Këtu duhet të përfshihen planifikimi i mjeteve për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse për ish punëtorët që nuk janë kompensuar si dhe ata që janë në prag të pensionimit, si dhe klasifikimi/ndarja e qartë e projekteve kapitale nga shpenzimet tjera si subvencionet apo mallrat dhe shërbimet.	Ne mostrat e testuara nuk kemi identifikuar ndonjë rast të tillë	I zbatuar

2.	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që Zyra e Tatimit në Pronë shqyrton ankesat brenda afatit të caktuar, si dhe puna në teren me rastin e inspektimit të pronave të jetë i dokumentuar në sistemin Protax, dhe dosjet të jenë të kompletuara me ortofoto.	Nga mostrat e testuara kemi vërejtur përmirësim, te dosjet që ishin të kompletuara.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që Zyra e Tatimit në Pronë ka zbatuar një plan të detajuar për të eliminuar dobësitë e identifikuara. Vendosija e kontrollit, ri verifikimi, anketimi i pronave do të mundësonte eliminimin e dobësive në regjistrin e pronave dhe kalkulimin e drejt të tatimit në pronë.	Në mostrat e testuara nuk kemi konstatuar mangësi të tilla	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurohet që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm, dhe për çdo pozitë të jetë siguruar se ka mjete buxhetore të mjaftueshme të aprovuara dhe ka vende të lira për përfshirje në listën e pagave. Në PFV duhet të shpalosen informatat e sakta në lidhje me numrin e të gjithë punëtorëve, përfshirë edhe ata jashtë listës së pagave.	Nuk ishte siguruar buxheti i mjaftueshme për kryerjen e obligimeve për mësimdhënësit e angazhuar në punë	Nuk është adresuar
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të siguroj se angazhimi me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, nevojat për pozitat të rregullta duhet të adresohen në Ministrinë e Financave gjatë planifikimit buxhetor.	Legjislacioni në lidhje me shërbimet e veçanta në mes të vitit 2020 ka ndryshuar dhe trajtimi i tyre është bërë me ligjin e ri pasi që me ligjin e vjetër ka përfunduar.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se do të shqyrtojë bazën ligjore të marrëveshjeve në fjalë dhe se për çdo shpenzim për të cilin sipas rregullave kërkohen procedura të prokurimit, do të vepohet konform dispozitave të Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe LMFPP-së.	Marrëveshja ishte e vitit 2018 dhe ishte për një afat 5 vjeçar. Ne nuk kemi identifikuar raste të reja që nuk është aplikuar ligji i prokurimit publik.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që nuk do të aprovohen subvencione përtej shumave të kërkuara, si dhe për çdo shpenzim të subvencioneve të sigurohen raportet kthyesë për të siguruar se mjetet janë shpenzuar në pajtim me qëllimin e subvencionit.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur ndonjë rast të tillë.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonësive dhe të kostove shtesë	Nuk janë specifikuar qartë sasi të për të gjitha kontratat kornize	Pjesërisht i zbatuar

		eventuale. Po ashtu në rastet kur aktivitetet nuk janë të planifikuara, duhet të njoftohen me kohë organet kompetente, konform rregullave të aplikueshme.		
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që asnjë kontratë e nënshkruar të mos e tejkalojë vlerën e projektit të parashikuar me ligjin e buxhetit.	Këtë vit kemi identifikuar vetëm një rast të tejkalimit, por kjo e çështje është trajtuar te Çështja C3.	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontratat publike kornizë të përpilohen në pajtim me kërkesat e RrUOPP dhe LPP, në mënyrë që çmimi i kontratës kornizë të jetë çmimi total i vlerës indikative sipas ofertës financiare fituese. Po ashtu për secilën kontratë me vlerë të mesme dhe të madhe duhet të caktohen menaxherët e kontratave të cilët përmes raporteve periodike dhe përmbledhëse sigurojnë se kontratat realizohen sipas kushteve të kontraktuara dhe me cilësinë e duhur. Në rastet kur ka tejkallim të vlerave të kontratave, ato duhet të ndërpriten.	Nuk janë identifikuar mangësi të njëjta.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari, fillimisht duhet të siguroj që në planifikim përfshihen të gjitha projektet, për të cilat ekzistojnë mundësitë reale të realizohen dhe të ndahet buxhet i mjaftueshëm për ekzekutimin e tyre. Nëse paraqitet nevoja për ri destinim të mjeteve, duhet të sigurohet aprovimi paraprak i Kuvendit Komunal.	Ne mostrat e testuara kemi identifikuar se ridestnimi i mjeteve ishte bërë me vendim paraprak, por që në SIMFK nuk ishte evidentuar ky ndryshim.	Pjesërisht i zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet (të viteve paraprake të paguara) të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.	Nga mostrat e testuar kemi konstatuar se kishte pagesa përmes procedurave gjyqësore/përmbartuesve.	Nuk është adresuar
13.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj që për çdo kontratë me vlerë të mesme dhe të madhe do të emërohen menaxherët e kontratave dhe do të hartohen planet për menaxhimin e tyre. Këto plane duhet të monitorohen në baza të rregullta dhe për progresin në zbatimin e kontratave të raportohet tek kryetari dhe tek zyra e prokurimit në baza të rregullta kohore një apo tre mujore.	Ne mostrat e testuar kemi identifikuar mungesë të planeve për menaxhim të kontratave.	Pjesërisht i zbatuar
14.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efikas të kontrolleve financiare për kryerjen e pagesave brenda afatit të paraparë ligjorë sa i	Kemi identifikuar vonesa edhe këtë vit për kryerjen e pagesave...	Nuk është adresuar



		përket realizimit të pagesave sipas rregullave në fuqi.		
15.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra dhe janë shpalosur në PFV, në pajtim me kërkesat ligjore. Sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet, dhe të krijohet një depo për pranimin e mallrave, për të mundësuar menaxhim dhe kontroll më të mirë të pasurive. Njëherit komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive duhet të formohen dhe funksionojnë sipas kërkesave për të mundësuar azhurnimin e regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare.	Në mostrat e testuara kemi identifikuar se E-pasuria nuk ishte funksionale ndërsa raporti për inventarizimin e pasurive ishte jo i plotë.	Nuk është adresuar
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të siguroj nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Të përgatit një plan veprimi për arkëtimin e tyre duke ndjekur procedura ligjore, me këshillim nga zyra e avokatit të komunës për veprimet ligjore. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen nëpër vite me një kujdes të veçantë.	Nga mostrat e testuar kemi konstatuar se nuk ishte mbajtur evidence e saktë për LLA dhe nuk ishin marre veprime të mjaftueshme për arkëtimin e tyre.	Nuk është adresuar
17.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj procedura të qarta për inkasimin e LLA, gjithashtu duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë në menaxhimin e tyre dhe që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve	Gjendja mbetet e pa ndryshuar edhe këtë vit me trend të rritjes së LLA-ve.	Nuk është adresuar
18.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj mekanizma për të vërtetuar historinë e borxheve, për të konfirmuar se nuk janë bërë përshtatje të parregullta apo lëshime. Po ashtu të rishikoj vendimin/raportin për faljen/kompenzimin e borxhit. Borxhet nga pronat publike në pronësi të komunës duhet të përcillen me përpikëri, njëherit për inkasimin e tyre duhet aplikuar të gjitha veprimet ligjore.	Nga mostrat e testuara kemi konstatuar se nuk kishte mekanizma të duhur për vërtetësinë borgjeve.	Nuk është adresuar
19.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se obligimet e mbetura në fund vit të raportohen saktë në PFV dhe të gjitha informatat për faturat e papaguara dorëzohen me kohë te ZKF. Me rastin e kryerjes së pagesave, përparësi duhet tu ipet faturave sipas kohës së pranimit, pra fillimisht të paguhen obligimet mbi 30 ditë pastaj obligimet tjera.	Nga mostrat e testuar kemi konstatuar se obligimet e papaguara nuk janë raportuar saktë dhe drejt në PFV dhe kishte vonesa në pagesën e tyre.	Nuk është adresuar

20.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e Komitetit të Auditimit. Komiteti duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.	Ne kemi konstatuar se komiteti i auditimit nuk kishte mbajtur asnjë takim gjatë vitit.	Nuk është adresuar
-----	----------------------	---	--	--------------------

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës si dhe shpalosur saktë në PFV. Sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet, për të mundësuar menaxhimin dhe kontrollin më të mirë të pasurive. Po ashtu, komisioni për inventarizim duhet të funksionoj sipas kërkesave për të mundësuar azhurnimin e regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare.
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efikas të kontrolleve financiare për raportimin e saktë të obligimeve dhe kryerjen e pagesave brenda afatit të paraparë ligjorë.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, personeli i Tatimit në Pronë duhet të shqyrtoj ankesat brenda afatit të përcaktuar.
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurohet që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave. Në PFV duhet të shpalosen informatat e sakta në lidhje me numrin e të gjithë punëtorëve, përfshirë edhe ata jashtë listës së pagave.
6.	Mallrat & Shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të filloj menjëherë pas hapjes së ofertave (brenda afateve ligjore), dhe të obligoj menaxherët e kontratave që planet për menaxhimin e kontratave të jenë hartuar para fillimit të zbatimit të tyre në mënyrë që kontratat të monitorohen në baza të rregullta.
7.	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të vendos kontrolle shtesë gjatë procedurave të prokurimit për të siguruar se ato zhvillohen në pajtim me kërkesat ligjore dhe ofrojnë vlerë të shtuar për parane e shpenzuar. Për më tepër, kriteret mbi peshimin e çmimeve sipas rëndësisë së artikujve duhet të jenë vendosur në mënyrë që të ketë bazë përcaktuese në përzgjedhjen e operatorit ekonomik (OE). Po ashtu, para nënshkrimit të kontratave fondet duhet të jenë në dispozicion, dhe regjistrimi i shpenzimeve të jetë nga projekti adekuat.
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e hartimit të paramasës dhe paralogarisë janë vlerësuar saktë pozicionet që duhet punuar, në mënyrë që ndryshimet gjatë ekzekutimit të projektit të minimizohen. Po ashtu, menaxherët e kontratave duhet të raportojnë çdo largim/shtim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe parapakisht duhet të marrin aprovimin nga ZKA. Po ashtu, duhet eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.

9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Menaxheri i prokurimit nuk duhet të përfshihet në pranimin e punëve e as zyrtarët të cilët janë të përfshirë në vlerësimin e tenderëve nuk mund të angazhohen në menaxhim të kontratave.
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që siguria e ekzekutimit është në përputhje me afatet e paraparë për përmbushjen e kontratave, në të kundërtën nuk duhet të lidhet kontrata. Pra siguria e ekzekutimit duhet të jetë valide për një periudhë prej tridhjetë ditë pas kompletimit të kontratave.
11.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.
12.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për një planifikim të drejtë të sasive indikative të kontratave kornizë në mënyrë që shpenzimi i buxhetit të bëhet në pajtim me tolerancën e lejuar +/- 30%. Tejkallimet e kontratave në këtë formë duhet të ndërprehen nga menaxherët e kontratave si preventiv për përmirësimet në të ardhmen.
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj procedura të qarta për inkasimin e LLA, gjithashtu duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë në menaxhimin e tyre dhe që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre.
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të siguroj nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Të përgatit një plan veprimi për arkëtimin e tyre duke ndjekur procedura ligjore, me këshillim nga zyra e avokatit të komunës për veprimet ligjore. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen nëpër vite me një kujdes të veçantë.
15.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj mekanizma për të vërtetuar historinë e borxheve, për të konfirmuar se nuk janë bërë përshtatje të parregullta apo lëshime. Po ashtu të rishikoj vendimin/raportin për faljen/kompenzimin e borxhit. Borxhet nga pronat publike në pronësi të komunës duhet të përcillen me përpikëri, njëherit për inkasimin e të arkëtueshmeve duhet aplikuar të gjitha veprimet ligjore.
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të financave se vendimet e Kuvendit Komunal zbatohen në procesin e faturimit të qirave. Po ashtu, të rishikoj faturimet e procesuara dhe aty ku ka bazë ligjore të bëhen korrigjimet e nevojshme.
17.	Detyrimet	Kryetari duhet të siguroj se obligimet e mbetura në fund vit të raportohen saktë në PFV dhe të gjitha informatat për faturat e papaguara dorëzohen me kohë te ZKF.
18.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e KA-së në mënyrë që Komiteti të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, KA duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhëmese e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Udhëheqës i Auditimit



Bahri Statovci, Udhëheqës i ekipit



Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajt, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Kryetari Agim Aliu

Data: 02.07.2021



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>11</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>12</sup> Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinionin i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

### Mohim i opinionit



Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Kontratat për furnizim me pako higjienike, furnizim me reagenca dhe mirembajtja dhe rregullimi i konstruksioneve dhe objekteve nga metali, druri dhe plastika
- <sup>6</sup> Kontrata "Ndertimi I kolektorit veriperendimor, Slivove -Kosine" (kontrata 3 vjeqare SE 2 vite) vlera 443,378€, Kontrata Rregullimi i shtratit të lumit të rruga Imri Halili (Kontrata 2 vjeqare SE 1 vit)vlera 143,869€, Ndertimi i stacionit të autobuseve (kontrata tri vjeqare SE 1 vit) vlera 487,245€, dhe Asfaltimi I rrugëve të qytetit Ferizaj (kontrata 3 vjeqare SE 1 vit)
- <sup>7</sup> Vlera prej 8,105€ ishte paraqitur më tepër, ndërsa 51,762€ nuk janë paraqit fare.
- <sup>8</sup> Vendimi ishte marr me arsyetimin se shoqatat e përmendura, nuk i kanë përmbush obligimet dhe i është ndërprerë kontrata dhe se nuk janë në gjendje ta paguajnë.
- <sup>9</sup> Pala nuk është pajtuar dhe ka bërë ankesë në lidhje me vlerën e shpronësimit në Gjykatën Themelore në Ferizaj me datë 26.09.2017 ; Fatura e vitit 2015 në vlerë 1,565€ dhe fatura e vitit 2017 në vlerë 7,473€
- <sup>10</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>11</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>12</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.